



Shpallje pune për Asistent të KPT-së

**Projekti i financuar nga Bashkimi Evropian
"Përforcimi i mëtejshëm i kapaciteteve për zbatimin efektiv të legjislativës nga fusha e ndotjes
industriale"
Nr. Ref. MK 20 IPA EN 02 22**

**ka nevojë për angazhim të
Asistentit të Këshilltarit të Përhershëm të Tuining-ut (KPT)**

Tuining-Projekti "Përforcimi i mëtejshëm i kapaciteteve për zbatimin efektiv të legjislativës nga fusha e ndotjes industriale" është projekt i përbashkët mes Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, dhe Republikës së Greqisë, e përfaqësuar nga Qendra për të Drejtën Ekonomike Ndërkombëtare dhe Evropiane (CIEEL).

Qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë në përforcimin e mëtejshëm të kapaciteteve lidhur me zbatimin efektiv të legjislativës nga fusha e ndotjes industrial në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Projekti ka nevojë të angazhojë një Asistent të Këshilltarit të Përhershëm të Tuining-ut (Asistent i KPT), detyrat e të cilit përfshijnë mbështetjen e KPT-së gjatë koordinimit dhe menaxhimit të Tuining-Projektit. Projekti ka nisur më 1 Mars 2023 dhe do të zgjasë 20 muaj.

Fillimi i angazhimit (indikative): **1 Shtator 2024.**

Asistenti i KPT-së do të punësohet me kontratë me orar të plotë pune, ndërsa lokacioni i vendit të punës do jetë në Shkup. Asistenti i KPT nuk duhet të jetë në asnjë marrëdhënie kontraktuale me sektorin publik në shtetin përfitues, Republikën e Maqedonisë së Veriut, të paktën 6 muaj para punësimit të tij.

Detyrat e Asistentit të KPT-së janë:

- Të veprojë si asistent kryesor i KPT, si dhe ekspertëve afatshkurtër;
- Të ndihmojë KPT në organizimin e misionëve të ekspertëve, trajnimeve, seminareve, punëtorive, takimeve të komitetit drejtues dhe ngjarjeve të tjera të projektit, duke përfshirë edhe aktivitetet e tjera online të Projektit;
- Hartimi i materialeve të shkruara në maqedonisht/shqip dhe anglisht;
- Menaxhimi i përgjithshëm në administrimin e zyrës, duke përfshirë evidencën, organizimin e trajnimeve, misionëve të ekspertëve, udhëtimet lokale, punën e përgjithshme në zyrë, etj.





- Organizimi i takimeve në bashkëpunim me partnerët e projektit, përgatitja e agjendave të takimeve dhe mbajtja e procesverbaleve;
- Zhvillimi dhe mbajtja e kontakteve dhe marrëdhënieve të ngushta pune me zyrtarët e Vendi Përfitues të përfshirë në secilin prej aktiviteteve dhe në menaxhimin e projektit;
- Menaxhimi i kontabilitetit buxhetor;
- Të veprjë si përkthyes dhe interpretues kur është e nevojshme;
- Hartimi dhe redaktimi i procesverbaleve të takimeve, të ndihmojë KPT në hartimin dhe redaktimin e raporteve mujore, tremujore dhe përfundimtare të projektit si dhe dokumenteve të tjera përkatëse;
- Aranzhimi i udhëtime, rezervime akomodimi si dhe organizimin e vizitave studimore;
- Menaxhimi i zyrës, monitorimi i korrespondencës online dhe telefonit.

Kualifikimet e nevojshme të kandidatëve:

Asistenti i KPT-së do të zgjidhet në përputhje me kriteret e mëposhtme të përzgjedhjes:

Përvoja dhe aftësitë e nevojshme:

- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze dhe maqedonase, të shkruar dhe të folur;
- Njohja e gjuhës shqipe do të ketë përparësi;
- Diplomë universitare;
- Aftësi menaxhimi me buxhetin;
- Eksperiencë në menaxhim zyre;
- Aftësi të shkëlqyera organizative;
- Aftësi të shkëlqyera kompjuterike (MS Word, Excel etj.);
- Përvojë të mëparshme në projekte të financuara nga BE ose projekte të tjera ndërkombëtare, ndërsa përvoja me IPA-Tuning do jetë aset;
- Njohja e terminologjisë së legjislacionit mjedisor paraqet aset.

Kandidatët duhet të dërgojnë biografitë e tyre (në format Europas) me letër motivimi në anglisht në adresën elektronike: eu.twinning.ied@gmail.com me titull „RTA Assistant” **jo më vonë se në datën 28 korrik 2024**. Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë.

Dokumentet që duhen bashkëngjitur në versionin e skanuar si pjesë e aplikimit:

- Diploma e arsimit të lartë;
- Certifikatë për njohjen e gjuhës (nëse ka);
- Rekomandime nga punëdhënës/it të mëparshëm (nëse ka).



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

